



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE GJAKOVË

Numri i lëndës: 2022:263349

Datë: 20.03.2023

Numri i dokumentit: 04096690

PKR.nr.177/22

NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA THEMELORE GJAKOVE, Departamenti për Krime të Rënda, gjyqtari **Sulltan Dobraj – kryetar i trupit gjykues**, me pjesëmarrjen e sekretares juridike Nushe kadrija, në çështjen penale kundër të pandehurit T. Nd.nga Gjakova, për shkak të veprës penale Mbajtja në pronësi, kontroll ose posedim të paautorizuar të armëve nga neni 366 par.1 të KPRK-së , duke vendosur lidhur me aktakuzën e PTH-se nga Gjakova PP/l.nr.312/2022 të dt.14.12.2022, në shqyrtimin gjyqësor të mbajtur me dt.15.03.2023, me pjesëmarrjen e prokurorit Deshire Jusaj, te pandehurit dhe mbrojtëses se tij av. Mone Syla nga Gjakova, me dt.17.03.2022 mori dhe publikisht shpalli, ndërsa me dt.**20.03.2023** përpiloi këtë:

A K T G J Y K I M

T. ND., nga i ati P. dhe e ëma M. e gjinisë D. , data e lindjes . . në fsh. . . , banon në rr. “. . .” K. Gjakovë, me nr. personal . . . , i martuar, ka të kryer shkollën fillore, me profesion punëtor, nr. telefonit . . . , shqiptar, shtetas i Republikës së Kosovës.

ESHTË FAJTOR

Për arsye se:

Nga dt. 13.08.2010 e gjer me dt.02.10.2022, në shtëpinë e tij në fsh. Trakaniq K. Gjakovë, në kundërshtim me Ligjin e zbatueshëm nr.05/L-022 për Armët në Kosovë, ka mbajtur në pronësi, kontroll ose posedim të paautorizuar pushkën e gjuetisë e llojit Over/Under cal. 12GA, prodhim turk me nr. serik: 146172 dhe katër fishekë të cal.12mm, ashtu që pas një bastisje të realizuar policore nga njësitë anti-drogës, të dyshuarit i gjendet një armë gjahu me leje të skaduar, e cila armë është konfiskuar nga policia.

Me çka ka kryer veprën penale mbajtja në pronësi, kontroll ose posedim të paautorizuar të armëve nga neni 366 prg.1 të KPRK-së.

Andaj, gjykata në kuptim të neneve 7, 17, 38, 43, 69, 70, nenit 366 par.1 lidhur me paragraf 3 të KPRK-ës, nenit 364, 452, të KPPRK-ës, të akuzuarin e:

G J Y K O N ME DENIM ME GJOBË

- I. I shqipton **DËNIMIN ME GJOBË**, në shumë prej **shtatëqind (700) Euro**, të cilën gjobë i pandehuri duhet të paguaj në afat prej 30 ditësh nga dita që ky aktgjykim të merr formën e prerë.
- II. Nëse i dënuari nuk dëshiron ose nuk mund ta paguaj gjobën, gjykata mund ta zëvendësoi dënimin me gjobë në shumë prej **shtatëqind (700) Euro**, në dënim me burgim në kohëzgjatje prej tridhjetepesë (35) ditësh, duke llogaritur për një ditë burgim të barabartë me 20 euro të gjobës.
- III. Konfiskohen **pushkën e gjuetisë e llojit Over/Under cal. 12GA, prodhim turk me nr. serik: 146172 dhe katër fishekë të cal.12mm** e sekuestruar në bazë të procesverbalit për kontroll dhe sekuestrimin të përkohshëm të sendeve nr. rasti 2022-YwP-04 të dt. 02.10.2022.
- IV. **Detyrohet** i pandehuri, që ti paguaj shpenzimet e paushallit gjyqësorë shumë prej pesëdhjetë (50) Euro, si dhe për Fondin për kompensimin e viktimave të krimit shumë prej pesëdhjetë (50) Euro, të gjitha këto në afat prej pesëmbëdhjetë (15) ditëve, nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi, ndërsa për shpenzime tjera të procedurës penale gjykata do të vendos me aktvendim të veçantë nëse gjen shpenzime të tilla.

A r s y e t i m

PTH në Gjakovë me aktakuzën PP/I.nr.312/2022 të dt.14.12.2022, ka akuzuar T. Nd.nga Gjakova, për veprën penale mbajtja në pronësi, kontrolle ose posedim të pa autorizuar të armëve nga neni 366 par.1. të KPRK-ës, ka propozuar të caktohet shqyrtimi fillestar kundër të njëjtit, të administrohen provat e dhura e me në fund i njëjti të shpallet fajtor dhe të dënohet sipas ligjit.

Gjykata Themelore në Gjakovë- Departamenti për krime të rënda me dt.15.03.2023 ka caktuar dhe ka mbajtur shqyrtimin fillestar ku pas leximit të aktakuzës i pandehuri e ka pranuar fajësinë, të cilin pranim fajësie gjykata e ka pranuar me aktvendim në procesverbal të shqyrtimit fillestar konform nenit 241 KPPK-ës.

Prokurori i shtetit në seancën për caktimin e dënimit i ka propozuar gjykatës që si rrethana lehtësuese të merr pranimin e fajësisë, ndërsa rrethanë rënduese të merr faktin se i pandehuri ka qen i dënuar edhe me parë.

Av. Mone Syla mbrojtëse e të pandehurit në seancën për caktimin e dënimit i ka propozuar gjykatës që si rrethana lehtësuese të merr pranimin e fajësisë, gjendjen e rëndë ekonomik, pendimi i tij i thellë, premtimi se në të ardhmen nuk do të kryej vepra të tilla.

I pandehuri në seancën për caktimin e dënimit ka deklaruar se mbështet deklarin e mbrojtësit, është shumë i penduar dhe ka premtuar se në të ardhmen nuk do të kryej vepra të tilla penale dhe është mbajtës i vetëm i familjes.

Gjykata me pranimin e fajësisë në tërësi e ka vërtetuar këtë gjendje faktike: i pandehuri me pare ka poseduar armën (me të dhëna të lartcekura) me leje deri më dt.13.08.2010 ku edhe i ka skaduar leja dhe nuk e ka vazhduar dhe as që ka provuar të vazhdojë lejen, ndërsa nga dt. 13.08.2010 e gjer më dt.02.10.2022, në shtëpinë e tij në fsh. . . . K. Gjakovë, në kundërshtim me Ligjin e zbatueshëm nr.05/L-022 për Armët në Kosovë, ka mbajtur në pronësi, kontroll ose posedim të paautorizuar pushkën e gjuetisë e llojit Over/Under cal. 12GA, prodhim turk me nr. serik: 146172 dhe katër fishekë të cal.12mm, ashtu që pas një bastisje të realizuar policore nga njësitë e anti-drogës, të dyshuarit i gjendet një armë gjahu me leje të skaduar, e cila armë është konfiskuar nga policia.

Gjykata paraprakisht të pandehurit i ka sqaruar natyrën dhe pasojat e pranimin të fajësisë dhe e ka udhëzuar se me pranimin e fajësisë i njëjti do të shpallet fajtor për veprën penale të lartcekur, do të shqiptohet sanksioni i paraparë me ligj, dhe se nuk do të këtë procedurë të provave.

Këtë gjendje faktike gjykata e ka vërtetuar nga pranimi i fajësisë që ka bërë i pandehuri i cili i ka pasur të njohura natyrën dhe pasojat e pranimin të fajësisë, dhe në mënyrë vullnetare, me vetëdije, pa ndonjë detyrim, mashtrim apo lajthim e ka pranuar fajësinë për veprën penale e cila i vihet në barë, i cili pranim fajësie mbështet në faktet e çështjes që përmban aktakuza, në materialet e prezantuar nga prokurori i shtetit, dhe se aktakuza nuk përmban asnjë shkelje ligjore ose gabime faktike.

Po ashtu gjykata duke u kujdesur zyrtarisht në kuptim të nenit 251 të KPPK-ës nuk ka gjetur ndonjë provë të pa pranueshme dhe gjithashtu është vërtetuar se i pandehuri e ka kuptuar natyrën dhe pasojat e pranimin të fajësisë konform nenit 241 të KPP-ës, ndërsa pranimi i fajësisë është bërë në mënyrë vullnetare, andaj kjo gjykate ka ardhur në përfundim se në veprimet e të pandehurit janë formuar të gjitha elementet e figurës së veprës penale mbajtura në pronësi, kontroll ose posedim të pa autorizuar të armëve nga neni 366 par.1. KPK-ës, ka konstatuar se i pandehuri ka qenë i vetëdijshëm për veprimet e ndërmarra, i ka dashur ato veprime dhe pasojën e shkaktuar e ka dëshiruar, për veprimet e tilla të cilat përmbushen elementet e veprës penale të lartcekur, është përgjegjës, andaj gjykata ka vendosur dhe të pandehurin e shpall fajtor për këtë veprë penale, i ka shqiptuar dënimin si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Gjykata në bazë të nenit 38 të KPK ka vlerësuar se dënimi i shqiptuar është në përputhje me shkallën e përgjegjësisë penale të pandehurit, shkallën e rrezikshmërisë shoqërore, dhe në këtë mënyrë do të ndikoj në arritjen e qëllimit të dënimit që parashihet në nenin 41 të KPRK-ës, si mase për parandalimin e të pandehurit por edhe si mase për parandalimin e personave të tjerë kryes potencial të veprave penale nga kryerja e veprave penale në të ardhmen, të shpreh gjykimin shoqëror për veprën penale, ngritjen e moralit dhe forcimin e detyrimit për respektimin e ligjit.

Gjykata në bazë të nenit 69 lidhur me nenin 70 të KPK, me rastin e vendosjes lidhur me lartësinë e dënimit gjykata i ka vlerësuar të gjitha rrethanat lehtësuese dhe rënduese, të cilat mund të ndikojnë në lartësinë dhe llojin e dënimit ndaj të pandehurit.

Kështu si rrethana lehtësuese gjykata ka gjetur se i pandehuri e ka pranuar fajësinë, pendimi i tij, pastaj kërkim falja nga ana e te pandehurit, faktin se arma ka qen me leje deri me dt. 13.08.2010, premtimi se në të ardhmen nuk do të kryerj vepra penale,

Ndërsa rrethana renduese gjykata nuk ka gjetur

Gjykata ne baze te nenit 46 paragraf 3 te KPK ka vendosur se nëse i dënuari nuk dëshiron ose nuk mund ta paguaj gjobën, gjykata mund ta zëvendësoi dënimin me gjobë në shumë prej **shtatëqind (700) Euro**, në dënim me burgim në kohëzgjatje prej tridhjetepesë (35) ditësh, duke llogaritur për një ditë burgim të barabartë me 20 euro të gjobës.

Gjykata në bazë të nenit 366 paragraf 3 te KPK ka vendosur dhe e ka konfiskuar pushkën e gjuetisë e llojit Over/Under cal. 12GA, prodhim turk me nr. serik: 146172 dhe katër fishekë të cal.12mm e sekuestruar në bazë të procesverbalit per kontroll dhe sekuestrimin të përkohshëm te sendeve nr. rasti 2022-YwP-04 te dt. 02.10.2022.

Gjykata në bazë të nenit 452 te KPPK e ka obliguar te pandehurin që gjykatës ti paguaj paushallin gjyqësorë në shumë prej 50 euro në afat prej 15 ditësh nga dita kur kz aktgjykim te marr formen e prere, ndërsa për shpenzimet e procedurës gjykata do të vendos me aktvendim të veçante.

Gjykata në bazë të nenit 36 paragraf 3 nën paragraf 3.2 ligjit për kompensimin e viktimave të krimit - LIGJI nr. 08/l-109. ka obliguar të pandehurin në emër të paguaj taksen fondit për kompensimin e viktimave të krimit në shumën 50 euro në afat prej 15 ditësh.

Duke u bazuar ne te lartcekurat u vendos si ne dispozitiv.

GJYKATA THEMELORE GJAKOVE
PKR.nr. PKR.nr.177/2022 te dt.20.03.2023

Sekretarja juridike:
Nushe Kadrija

Kryetari i trupit gjykues:
Sulltan Dobraj

KËSHILLA JURIDIKE :

Kundër këtij aktgjykimi lejohet ankesa në afat prej **30 ditësh** nga dita e pranimit të kopjes së këtij aktgjykimi, drejtuar Gjykatës se Apelit në Prishtinë përmes Gjykatës Themelore Gjakove.